



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 130/1 Prot.

Tiranë, më 18.01.2022

V E N D I M

Nr. 20, Datë 18.01.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 138, datë 27.07.2021, të paraqitur nga A.V, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan (DROSHKSH Elbasan) dhe Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat (NJVKSH Berat).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe e-mail-et datë 27.07.2021 dhe 30.07.2021, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Në vitin 2009 është emëruar në detyrën e Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare për Qarkun Berat, dhe këtë detyrë e ka vazhduar pa ndërprerje deri në datë 19.05.2019, kur i është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të njëanshme, pa një shkak të justifikuar apo të arsyeshëm dhe është zëvendësuar nga Xh.K që ishte Kryetare e Forumit Rinor të Partisë Socialiste, Dega Berat. Pas kësaj date, vijon të punojë në detyrën e Mjekut të Shërbimit të Mjekësisë Familjare të Qarkut Berat. Ankuesi shpjegon se angazhimi i tij politik ka qenë i njohur nga punëdhënësi dhe aktiviteti i tij politik ishte dhe shkak i zgjidhjes së kontratës së punës në datë 19.05.2019. Së fundmi, prej disa muajsh Xh.K ushtron funksionin e Drejtores së

¹ Referuar Vërtetimit nr. 54, datë 15.06.2021, të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Berat, A.V është anëtar i Partisë Demokratike që nga data 25.05.1997 dhe ka përfaqësuar Partinë Demokratike si kandidat për deputet në vitin 2001 dhe Këshilltar Bashkiak në Bashkinë Berat, në vitet 2007-2011.

NJVKSH Berat, pa konkurs dhe pa shpallje të vendit vakant. Në datë 30.06.2021, Drejtoria Rajonale e OSHKSH Elbasan ka shpallur njoftimin për punësim, për pozicionin e Shefit të Shërbimit në NJVKSH Berat (pozicioni prej të cilit e kishin larguar në mënyrë të jashtëligjshme). Ditën e nesërme është njoftuar nga institucioni me SMS, se zhvillohet konkursi për pozicionin e Shefit të Shërbimit, ndërsa mendon se rezultati është i paracaktuar, për arsye me prapavijë politike. Ankuesi pretendon se po trajtohet në mënyrë të pabarabartë krahasuar me Xh.K , për të cilën nuk është organizuar konkurs, pasi është Kryetare e FRESH, ndërsa për ankuesin është shpallur pozicioni vakant”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për rivendosjen e të drejtës së çenuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1 të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/a), b)², ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu shpalljen e vendeve të lira të punës dhe rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të

² Neni 12/1, të ligjit 10221/2010, të ndryshuar: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 138, datë 27.07.2021, të bërë nga A.V, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1118/2, datë 03.08.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, DROSHKSH Elbasan dhe NJVKSH Berat për ankesën e bërë nga A.V si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për shkarkimin e A.V nga pozicioni i Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare për Qarkun Berat (maj 2019).
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për emërimin e Xh.K në pozicionin e Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare për Qarkun Berat (maj 2019).
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për pozicionin e punës së Shefit të Shërbimit të shpallur në datë 30.06.2021.
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për emërimin e Xh.K në pozicionin e drejtores së NJVKSH Berat.
 - Informacion për punonjës të tjerë që janë emëruar në NJVKSH Berat, pa ndjekur procedurat e konkurimit, nga data 01.07.2020 deri në datë 30.06.2021.
 - Kopje të Udhëzimit nr. 514, datë 18.09.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzim nr. 673, datë 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me shkresën nr. 528/1, datë 10.08.2021, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “A.V ka filluar marrëdhënien e punës me konkurim në Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Berat në datë 25.05.2010, në pozicionin “Mjek për Institucionet e Arsimit Shkollor dhe Parashkollor në

Shërbimin e Mjekësisë Familjare”. Me shkresën nr. 1005/2, datë 12.11.2010 është emëruar me transferim nga pozicioni që ishte në pozicionin “Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare”.

Në bazë të Vendimit nr. 419, datë 04.07.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor” dhe Urdhërit nr. 902, datë 27.12.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat”, është krijuar Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat dhe është kryer ristrukturimi i institucionit të DRSH Berat. Për pasojë janë njoftuar punonjësit e DSHP Berat për ndryshimin e pozicionit të punës sipas organikës së re dhe kanë kaluar në pozicionet e reja të punës në bazë të diplomave.

Me shkresën nr. 32/207, datë 28.03.2019 të DROSHKSH Elbasan, A.V është njoftuar për ndryshimin e pozicionit të punës në bazë të organikës së re të institucionit dhe kalimin e tij nga “Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare” në pozicionin e punës “Specialist Mjek” në Sektorin e Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat. Ndryshimi i pozicionit të punës nga “Shef Sektori” në “Specialist” ka ardhur si pasojë e ristrukturimit të institucionit dhe jo për arsye politike. Informojmë se me ristrukturimin e institucionit pozicioni i punës “Shef Shërbimi i Mjekësisë Familjare” nuk ekziston më si vend pune. A.V ka refuzuar pozicionin e ri të punës, por pas refuzimit nuk është ndërprerë marrëdhënia e punës me NJVKSH Berat. Gjithashtu, A.V ka paraqitur ankesën datë 27.05.2019 pranë DROSHKSH Elbasan, në të cilën parashtron arsyetimin se ka eksperiencë pune si mjek, aftësi profesionale, ka dhënë sugjerime, por asnjëherë nuk parashtron faktin e diskriminimit për bindjen politike.

Ju bëjmë me dije se për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, gjendjes shëndetësore dhe moshës së A. V, në zbatim të Urdhërit nr. 80, datë 17.11.2020 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave standarte të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19 dhe periudhës së kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020-2021”, të DAP, pas kërkesave të vazhdueshme të tij, A. V ka punuar nga shtëpia.

Xh.K ka filluar marrëdhënien e punës me konkurim me DRSH Berat, në datë 27.04.2017, në pozicionin “Mjeke Stomatologe” në Shërbimin Stomatologjik Publik, dhe me shkresën nr. 413/1, datë 01.03.2018, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe shkresën nr. 211, datë 12.03.2018 të DRSH Berat është emëruar me transferim në detyrën e “Nëndrejtorit Teknik” të DRSH Berat. Në vitin 2019 është kryer ristrukturimi i institucionit dhe me shkresën nr. 32/206, datë 28.06.2019, të DROSHKSH Elbasan, Xh.K ka kaluar nga pozicioni “Nëndrejtor Teknik” në DSHP Berat, në pozicionin “Shefe e Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor” në NJVKSH Berat. Gjatë periudhës së pandemisë, Xh.K ka kryer detyrat funksionale të drejtorit të institucionit, pasi titullari ishte me raport paaftësie të përkohshme në punë. Me Urdhërin nr. 17, datë 12.02.2021, të DROSHKSH Elbasan është emëruar përkohësisht në pozicionin e punës “Drejtor i NJVKSH Berat” deri në kryerjen e procedurave të konkurimit në bazë të Udhëzimit nr. 673, datë 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitale Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH (i ndryshuar).

Ju bëjmë me dije se, nga periudha 01.08.2020, për shkak të daljes në pension të sanitares në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse janë kryer transferime të punonjësve brenda organikës, në bazë të kërkesës së punonjësve për të ndryshuar pozicionin e punës sipas diplomës. Kështu, punonjësja në pozicionin “Operatore” ka paraqitur kërkesë për pozicionin “Sanitare” dhe punonjësi në pozicionin “Ndihmës Higjenist”, me kërkesë të tij kaloi në pozicionin “Operator”. Ndërsa punonjësja e cila ishte në pozicionin “Infermiere” u transferua në pozicionin “Sanitare” dhe më pas kaloi në pozicionin “Ndihmës Higjeniste”. Në muajin Tetor 2020, është kryer transferimi i Shefit të Sektorit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor në pozicionin e punës “Mjek Specialist për Shëndetin Mjedisor”, për shkak të moskryerjes së detyrave funksionale. Gjithashtu, është kryer kalimi i punonjësës, nga pozicioni “Mjek Specialist për Shëndetin Mjedisor” në pozicionin “Shef i Sektorit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor”. Në muajin Qershor 2021, punonjësja në pozicionin “Ndihmës Epidemiologe” ka marrë lejen e lindjes dhe NJVKSH Berat, me shkresën nr. 426, datë 17.06.2021 ka kërkuar shpalljen e vendit vakant provizor, por nuk është publikuar në faqen e OSHKSH, pasi është vend pune provizor. Për pasojë NJVKSH Berat ka punësuar me kontratë me periudhë kohe të caktuar, punonjësën S.Z.

NJVKSH Berat ka shpallur pozicionin “Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor”, për të cilin është zhvilluar konkurimi, dhe ka marrë pjesë dhe A.V. Janë paraqitur 5 kandidatë, nga të cilët 2 janë skualifikuar, pasi nuk plotësonin kriterin e diplomës në Mjekësi/Shëndet Publik. Ndërsa 3 kandidatët e tjerë janë vlerësuar në bazë të Udhëzimit nr. 673, datë 02.10.2019. Ju bëjmë me dije se gjatë intervistës me gojë A.V është shprehur se ai ka bindje politike të djathta, ndonëse Komisioni i Vlerësimit nuk ka parashtruar pyetje mbi bindjet politike të kandidatëve, dhe nuk ka marrë informacion paraprak për kandidatët mbi këtë çështje. Informojmë, se bazuar në shkresën nr. 427/1, datë 17.06.2021, për pozicionin e punës “Shef i Sektorit të Shërbimeve të Kujdesit të Shëndetit Parësor”, NJVKSH Berat ka kërkuar si kriter punësimi arsimin e lartë në Mjekësi/Shëndet Publik dhe diplomën me listën e notave të masterit shkencor/profesional, por nuk ka përcaktuar si kriter minimal masterin shkencor. Për këtë arsye diploma e nivelit të dytë master profesional nuk përbën kusht skualifikues. Për sa i përket njoftimit në faqen zyrtare të OSHKSH ku kërkohet arsimi minimal master shkencor dhe kriter çertifikata për kryerjen e trajnimit për prozektues pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, janë kriteret të cilat Komisioni i Vlerësimit nuk i ka marrë për bazë, pasi nuk përkojnë me kriteret e kërkuara në shkresën nr. 427/1, datë 17.06.2021. Kjo ka qenë dhe një nga arsyet e ankesës së kandidatëve të tjerë. Në bazë të Udhëzimit nr. 673, datë 02.10.2019, të ndryshuar, Kreu III, pika 2, skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Në shtojcën I, pika 4, përcakton se, kandidati me master profesional vlerësohet me 1 pikë, kandidati me master shkencor vlerësohet me 2 pikë, ndërsa për studime shtesë kandidati vlerësohet deri në 4 pikë. Për këtë arsye, pretendimi i kandidatëve për skualifikim për arsye të diplomës master profesional në Shëndet Publik të kandidates D.C, është i pabazuar. Ju bëjmë me dije se D.C disponon diplomën “Master Shkencor në Administrim Publik”.

Në kundërshtim të parashtrimeve të Njësisë Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat, ankuesi me shkresën datë 13.08.2021, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“NJVKSH Berat shprehet se me shkresën nr. 427/1, datë 17.06.2021 ka përcaktuar si nivel minimal arsimimi për pozicionin “Shef i Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor” diplomën Master Shkencor/Profesional. Për këtë arsye, sipas NJVKSH, komisioni i vlerësimit nuk e ka marrë parasysh nivelin minimal Master Shkencor (nga Universiteti i Mjekësisë) të shpallur nga DROSHKSH Elbasan. Në këtë mënyrë NJVKSH pranon se ka nxjerrë akte zyrtare në kundërshtim me organin epror, çka është e pakuptimtë dhe joligjore. NJVKSH Berat shprehet se pozicioni i punës që unë mbaja deri në ristrukturimin e institucionit “Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare” nuk ekziston më. Ju bëj me dije se funksionet që kryente para ristrukturimit Shërbimi i Mjekësisë Familjare, kryhen sot prej Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor. Pra, Shërbimi, njësoj si Institucioni, ka ndryshuar emërtimin e tij, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet se nuk ekziston më. NJVKSH Berat ngre pretendimin se unë jam njoftuar prej institucionit për largimin tim si shef me anë të një shkrese. Më duhet t’ju informoj se nuk më është paraqitur asnjë shkresë për largimin tim nga pozicioni i punës dhe asnjëherë nuk kam firmosur ndonjë shkresë të tillë. NJVKSH Berat pranon se Xh.K është emëruar në pozicionin e shefes së Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor, pa konkurs. Kjo ndodhi për arsye se pozicioni i Nëndrejtoreshës u suprimua pas ristrukturimit të institucionit dhe u lakmua pozicioni im nga zonja në fjalë. NJVKSH Berat ngre një pretendim të pandershëm kur shprehet se gjatë intervistës me gojë për procedurën e konkurimit unë jam shprehur se “kam bindje të djathta”. Në të vërtetë paraqitja me gojë e përvojës sime 40-vjeçare në profesionin e mjekut dhe drejtuesit ishte aq voluminoze saqë Kryetarja e Komisionit të Vlerësimit Xh.K më ndërpreu, ashtu si bëri edhe gjatë provimit me shkrim, duke shprehur pakënaqësi për zgjatjen time në aspektin profesional. Me këtë situatë ku nuk më jepej koha të paraqisja përvojën time të pakrahasueshme me kundërshtaren e favorizuar (çka Komisionit nuk i pëlqente), nuk ishte vendi për diskutime politike, madje i jam lutur në mënyrë të përsëritur mos të më pengonte në mënyrë kaq flagrante. Për më tepër, menjëherë pas konkursit kërkova verbalisht e më pas me anë të një shkrese zyrtare, që ka ardhur “për dijeni” edhe pranë KMD, të më vihej në dispozicion procesverbali përfundimtar i konkursit. Mospajisja ime me këtë procesverbal vë në dyshim edhe pretendimet e NJVKSH Berat mbi atë se çfarë kam thënë gjatë intervistës me gojë. Kjo panoramë që Ju paraqita më sipër, provon largimin në mënyrë të paligjshme nga pozicioni që mbaja. Gjithashtu, konkursi i zhvilluar për pozicionin “Shef i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor” provohet të jetë i paracaktuar, pasi pjesëmarrja e fitueses së shpallur znj. D.C³ është në kundërshtim me kriteret e DROSHKSH Elbasan. Shtuar këtu edhe trajtimi im i diferencuar në raport me Xh.K në aspektin e emërimeve pa konkurs në pozicione të ndryshme drejtuese, provon diskriminimin ndaj meje në bazë të bindjeve politike”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 138, datë 27.07.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1118/5, datë 13.10.2021 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore

³ Ankuesi me e-mail-in datë 30.07.2021, informon se bashkëshorti i D.C, është anëtar i Këshillit Bashkiak Berat, si përfaqësues i subjektit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

me datë 26.10.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, A.V dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 1560, datë 25.10.2021, të DROSHKSH Elbasan, Xh.K , me detyrë Drejtore e NJVKSH Berat.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përfaqësuesja e DROSHKSH Elbasan, i qëndroi parashtrimeve të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe deklaroi⁴ se në kriterin e shpallur për nivelin minimal të arsimit, (Master shkencor) në njoftimin për punësim për pozicionin shef shërbimi është bërë një gabim material në shpallje nga ana e Drejtorisë Qendrore të OSHKSH, pasi nga ana e NJVKSH-së nuk është kërkuar një kriter i tillë por dhe master profesional. Gjithashtu, Xh.K informoi se procedura e emërimit nuk do vazhdojë deri sa të zgjidhet nga ana e DROSHKSH Elbasan e gjithë problematika e dosjes së konkurimit.

Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, NJVKSH Berat me e-mail-in datë 02.11.2021, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi se: *“Publikimi i njoftimit nga DQOSHKSH Tiranë për nivelin minimal të diplomës “Master Shkencor” bazohet në VKM nr. 1076, datë 24.12.2020 “Për disa shtesa në VKM nr.555, datë 11.08.2011 për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajnimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, i ndryshuar. NJVKSH Berat ka përcaktuar si kriter punësimi arsimin e lartë në Mjekësi/Shëndet Publik dhe diplomën me listën e notave të masterit shkencor/profesional dhe për emërimin e kandidatit në këtë pozicion pune për efekt të nivelit të pagës, është e nevojshme disponimi i një diplome të nivelit të dytë shkencor. D.C disponon diplomën “Master Profesional në Shëndet Publik” dhe “Master Shkencor në Administrim Publik”. Gjithashtu procedura e punësimit është në proces ankimimi pranë DROSHKSH Elbasan dhe ende nuk është miratuar emërimi i D.C në pozicionin e punës “Shefe e Sektorit të Shërbimit Parësor dhe Vlerësimit të Cilësisë” në bazë të pikës 8 të kreut I të Udhëzimit nr. 673, datë 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH”, i ndryshuar. Aktualisht D.C është komanduar si Shefe e Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor dhe Vlerësimit të Cilësisë, pa efekt pagese, pasi për shkak të situatës së krijuar*

⁴ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 1.23.00 deri 1.26.15.

nga sëmundja infektive COVID-19, ky shërbim ruan një rol të rëndësishëm në kontrollin dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor nga 14 Qendrat Shëndetësore në varësi të NJVKSH Berat”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për largimin e tij nga pozicioni i Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare për Qarkun Berat, në datë 28.03.2019.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe bazuar në nenin 33/4, germa “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*4. Ankesa nuk pranohet nëse: dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese*”, Komisioneri vlerëson se ky pretendim i parashtruar në ankesë, nuk duhet të pranohet pasi është paraqitur përtej afateve ligjore të parashikuara nga germa “dh”, e pikës 4, të dispozitës ligjore të sipërcituar, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, formulimi në nenin 33/4, germa “dh”, e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon se afati maksimal 3 vjeçar, nga momenti i ndodhjes së diskriminimit dhe afati maksimal 2 vjeçar, nga momenti i marrjes dijani për diskriminimin, nuk

janë afate kumulative. Për t'u konsideruar brenda afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave nga ana e Komisionerit, ankuesi mund të provojë ose se nuk kanë kaluar 3 vjet nga ndodhja e diskriminimit, pavarësisht se kur ka marrë dajeni, ose në rast se provon se momenti i marrjes dajeni është i ndryshëm nga momenti i ndodhjes së diskriminimit, ankuesi është brenda 2 viteve nga marrja dajeni.

Së dyti, fakti diskriminues i pretenduar nga ankuesi, rezulton të ketë ndodhur në datë 28.03.2019 kur me shkresën nr. 32/207 të DROSHKSH Elbanan, është njoftuar për transferim për shkak të ristrukturimit/transformimit të institucionin. A.V ka pasë dajeni për transferimin e tij, pasi me shkresën datë 27.05.2019, drejtuar Drejtorit të DROSHKSH Elbasan është ankuar për zëvendësimin e tij në pozicionin e shefit të shërbimit të mjekësisë familjare dhe ka kërkuar që të rikthehet në detyrën e tij. Ankuesi ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit, në datën 21.07.2021 dhe e ka plotësuar atë në datë 27.07.2021, pra në tejkalim të afatit 2 vjeçar të parashikuar në nenin 33/4, germa “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Së treti, ankuesi justifikon afatin e paraqitjes së ankimit të tij, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, duke argumentuar se bazuar në këtë akt, janë pezulluar afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Lidhur me këtë pretendim, sqarojmë se akti normativ i sipërpërmendur i përket veprimtarisë gjyqësore dhe të prokurorisë, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë dhe jo veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Komisioneri gjatë gjithë periudhës së gjendjes së epidemisë ka vazhduar veprimtarinë e tij, duke pranuar ankesa, brenda masave kufizuese të vendosura nga autoritetet përkatëse.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushet kriteri ligjor për pranimin e pretendimit për largimin nga pozicioni i Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare, por do ndjekë procedurat ligjore lidhur me pretendimin për procedurat e konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të shpallur me datë 30.06.2021.

B. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, gjatë procedurave të konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të shpallur me datë 30.06.2021.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se ankuesi A.V ka filluar marrëdhënien e punës me konkurin në Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Berat në datë 25.05.2010, në pozicionin “Mjek për Institucionet e Arsimit Shkollor & Parashkollor në Shërbimin e Mjekësisë Familjare”. Me shkresën nr. 1005/2, datë 12.11.2010 është emëruar me transferim nga pozicioni që ishte në pozicionin “Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare”. Në bazë të VKM-së nr. 419, datë 04.07.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit

të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor” dhe Urdhërit nr. 902, datë 27.12.2018 “Përmiratimin e strukturës dhe organikës së Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat”, është krijuar Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat dhe është kryer ristrukturimi i institucionit të DROSHKSH Berat. Me shkresën nr. 32/207, datë 28.03.2019 të DROSHKSH Elbasan, A.V është njoftuar për ndryshimin e pozicionit të punës në bazë të organikës së re të institucionit dhe kalimin e tij nga “Shef i Shërbimit të Mjekësisë Familjare” në pozicionin e punës “Specialist Mjek” në Sektorin e Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

Me shkresën nr. 32/206, datë 28.06.2019 të DROSHKSH Elbasan, Xh.K është njoftuar për ndryshimin e pozicionit të punës në bazë të organikës së re të institucionit dhe kalimin e saj nga pozicioni “Zv. Drejtor Teknik”, në pozicionin “Shef Shërbimi në Sektorin e Shërbimeve të Kujdesit të Shëndetit Parësor Berat”. Me Urdhërin nr. 17, datë 12.02.2021 të DROSHKSH Elbasan është bërë emërimi i përkohshëm i Xh.K në pozicionin Drejtor i NJVKSH Berat, deri në kryerjen e procedurave të konkurimit.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjes politike, pasi kandidatja D.C, e renditur në vend të parë, duhet të ishte skualifikuar nga komisioni i vlerësimit, pasi nuk plotëson kriterin e arsimit (master shkencor) të shpallur nga Drejtoria Qendrore e OSHKSH-së (DQOSHKSH).

NJVKSH Berat me shkresën nr. 427, datë 17.06.2021, ka informuar DROSHKSH Elbasan se është vendi vakant në pozicionin e punës, “Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor” dhe ka kërkuar lejimin e kryerjes së të gjitha procedurave të punësimit për vendin vakant.

NJVKSH Berat me shkresën nr. 427/1, datë 17.06.2021, drejtuar DROSHKSH Elbasan ka dërguar kriteret për punësim për pozicionin e punës, “Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor”. Në kërkesat dhe kriteret për pozicionin ka kërkuar: - Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Mjekësi/Shëndet Publik. Të interesuarit në mes të tjerash duhet të paraqesin: - Diploma dhe listë notash master profesional/shkencor.

Nëpërmjet Njoftimit datë 30.06.2021, DQOSHKSH ka shpallur⁵ procedurën për plotësimin e pozicionit vakant të Shefit të Shërbimit pranë NJVKSH Berat. Referuar këtij njoftimi, në kriterin e arsimit rezulton se është kërkuar: “Arsim i Lartë, Universiteti i Mjekësisë (Mjekësi/Shëndet Publik). Niveli minimal i arsimit: Master Shkencor”, dhe aplikimet do të pranoheshin nga data 30.06.2021 deri në datë 07.07.2021.

Me Urdhërin nr. 45/1, datë 12.07.2021, të DROSHKSH Elbasan, është krijuar komisioni i vlerësimit për procedurat e punësimit për pozicionin “Shef i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Parësor”, i përbërë nga Xh.K, Kryetar, O.H anëtar dhe L.L anëtar i DROSHKSH.

Me shkresën nr. 515, datë 29.07.2021 drejtuar DROSHKSH Elbasan, NJVKSH Berat ka kërkuar miratimin e punësimit të D.C në pozicionin Shef i Sektorit të Shërbimit Parësor në NJVKSH Berat.

⁵ <http://oshksh.gov.al/njoftim-per-punesim-207/>

Në këtë shkresë NJVKSH Berat ka informuar DROSHKSH Elbasan se ka përfunduar procedura e konkurimit, në të cilin janë paraqitur pesë kandidatë, dy nga të cilët janë skualifikuar për shkak se nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë në Mjekësi/Shëndet Publik, ndërsa kandidatët e tjerë janë renditur me pikët si më poshtë: 1. D.C – 87 pikë (vlerësimi i dosjes 17 pikë, vlerësimi i testimit me shkrim 30 pikë dhe vlerësimi i testimit me gojë 40 pikë). 2. A.V – 81 pikë (vlerësimi i dosjes 18 pikë, vlerësimi i testimit me shkrim 28 pikë dhe vlerësimi i testimit me gojë 35 pikë). 3. D.M – 73 pikë (vlerësimi i dosjes 18 pikë, vlerësimi i testimit me shkrim 25 pikë dhe vlerësimi i testimit me gojë 30 pikë).

A.V pasi është vënë në dijeni të rezultateve të konkursit, me shkresën e protokolluar pranë NJVKSH Berat, me nr. 544, datë 10.08.2021, është ankuar lidhur me rezultatin e konkurimit.

NJVKSH me shkresën nr. 579, datë 01.09.2021, i ka kthyer përgjigje ankuesit, në të cilën në mes të tjerash e ka informuar se, NJVKSH ka kërkuar si kriter punësimi arsimin e lartë në Mjekësi/Shëndet Publik dhe diplomën e listën e notave të masterit shkencor/profesional, por nuk ka përcaktuar si kriter minimal masterin shkencor dhe qëndrimi i Komisionit të Vlerësimit nuk ka qenë i njëanshëm dhe diskriminues gjatë provimit me shkrim dhe intervistës me gojë pasi janë kryer të njëjtat pyetje dhe për kandidatët e tjerë.

Detyrat dhe kompetencat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe organeve në varësi përcaktohen nga VKM-ja nr. 419, datë 04.07.2018 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”*. Në Kreun III, pika 8/ç të këtij vendimi, përcaktohet se: *“8. Drejtoritë rajonale kryejnë detyrat si më poshtë vijon: ç) Kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndetin publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi, etj) për rajonin përkatës”.*

Procedurat për punësimin e punonjësve specialist deri titullar institucioni në drejtorinë qendrore të OSHKSH, drejtoritë rajonale të OSHKSH, në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, si dhe në administratën e spitaleve rajonale e bashkiake rregullohen sipas Udhëzimit nr. 673, datë 02.10.2019 *“Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, Spitalet Rajonale/Bashkiake dhe NJVKSH”*, të ndryshuar, të MSHMS. Në Kreun I, pika 8 parashikohet se: *“Drejtorët e NJVKSH emërohen dhe lirohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të OSHKSH, pasi merr miratimin nga drejtori i përgjithshëm i OSHKSH. Për pozicione të tjera të NJVKSH, për të cilat kërkohet arsim i lartë, emërimi dhe lirimi bëhet nga titullari i NJVKSH, pasi merr miratim nga drejtori i drejtorisë rajonale të OSHKSH”.*

Shpallja e vendeve të lira të punës dhe aplikimi parashikohen në Kreun II të këtij udhëzimi, në të cilin përcaktohet se: *“1. Institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen dhe raportojnë sipas varësisë hierarkike pranë DROSHKSH, DQOSHKSH ose MSHMS. 2. Shpallja e vendeve vakant bëhet në faqen zyrtare të DQOSHKSH, për pozicionet që janë emërtesë e ministrit dhe në faqen zyrtare të MSHMS. Gjithashtu shpallja bëhet dhe në faqen e internetit të institucionit, në rast se kanë të tillë. 3. Shpallja përmban kushtet*

dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranimin, fushën e njohurive, dokumentet që duhet të dorëzohen, afatin e dorëzimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe mënyrën e komunikimit të vlerësimit”.

Në Kreun IV, pika 1, germa g) përcaktohet se: “1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë sipas autoritetit që bën emërimin, miratohet si më poshtë: g) Për pozicionet e punës në NJVKSH, për të cilat kërkohet arsim i lartë, komisioni krijohet nga DROSHKSH dhe ka në përbërje tre anëtarë, si më poshtë vijon: iv. Drejtori i NJVKSH kryetar i komisionit; v. 1 (një) përfaqësues nga DROSHKSH; vi. 1 (një) përfaqësues nga NJVKSH”, ndërsa në pikën 2 përcaktohen detyrat e komisionit të vlerësimit si më poshtë: “a) administron dosjet e aplikantëve; b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim; c)”.

Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i OSHKSH-ve, rregullohet sipas parashikimeve të bëra në “Rregulloren e Brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, të miratuar me Urdhrin nr. 18, datë 17.01.2019 të MSHMS. Në nenin 13, pika 5 përcaktohet se: “Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në Elbasan, përfshin qarqet Korçë, Elbasan dhe Berat”. Në nenin 14, germa d) të kësaj rregulloreje përcaktohet se: “Detyrat e Drejtorive Rajonale; d) Të kryejë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndet publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi, etj) për rajonin përkatës”.

Në nenin 19 të kësaj rregulloreje përcaktohet se: “1. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e DROSHKSH është përgjegjëse për funksionet dhe detyrat e financave, shërbimeve juridike dhe shërbimet e përgjithshme mbështetëse”, ndërsa në pikën 3 të këtij neni përcaktohen detyrat e Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të cilat janë: “a) Menaxhimi i çështjeve që lidhen me burimet njerëzore në institucionet shëndetësore të rajonit. b) Identifikon nevojat për rekrutim për personelin mjekësor dhe stafin tjetër të të gjitha institucioneve shëndetësore të rajonit. e) Organizon procedurën e rekrutimit sipas udhëzimeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për pozicionet e tjera në institucionet shëndetësore”.

Në nenin 25 të rregullores së mësipërme përcaktohet se: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse i NJVKSH kryen detyrat si më poshtë: “a) Evidenton personelin e shërbimit shëndetësor; b) Njeh në çdo kohë gjendjen dhe nevojat e shërbimit shëndetësor për personel të mesëm dhe të lartë mjekësor dhe jo mjekësor; e) Raporton vendet vakant pranë Drejtorisë Rajonale”.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar rezulton se, detyra e vetme në procesin e rekrutimit të punonjësve me arsim të lartë e NJVKSH është të identifikojë dhe raportojë pranë drejtorisë rajonale për vendet vakant, por në asnjë dokument nuk rezulton që njësia vendore vendos kriteret për pozicionet e punës me arsim të lartë.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se janë drejtoritë rajonale që kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shpallin kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

Referuar njoftimit të datës 30.06.2021 për pozicionin shef shërbimi në NJVKSH Berat, rezulton se në shpalljen e publikuar nga autoriteti përgjegjës (OSHKSH), kriteri ka qenë: arsim i lartë, Universiteti i Mjekësisë (Mjekësi/Shëndet Publik). Niveli minimal i arsimit: Master Shkencor. Bazuar në këtë kriter të shpallur publikisht, kandidatë të ndryshëm kanë shfaqur interesin e tyre dhe kanë dorëzuar aplikimet.

Në përgjigjen e dërguar me shkresën nr. 528/1, datë 10.08.2021, NJVKSH Berat, informon se komisioni i vlerësimit nuk ka marrë për bazë kriterin ku kërkohet arsimi minimal master shkencor dhe dorëzimi i çertifikatës për kryerjen e trajnimit për prozektues pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, pasi nuk përkojnë me kriteret e kërkuara në shkresën nr. 427/1, datë 17.06.2021 të NJVKSH Berat.

Referuar detyrave që ka komisioni i vlerësimit të përcaktuara në Udhëzimin nr. 673, datë 02.10.2019, të ndryshuar, rezulton se ky komision, nuk ka tagrin që të ndryshojë kriteret e shpallura nga autoriteti përgjegjës, por në situatën e krijuar duhet të kishte vënë në dijeni autoritetin përgjegjës për gabimin material të pretenduar dhe të prisnin udhëzimet sipas rastit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e NJVKSH Berat informoi⁶ se për gabimin material të bërë gjatë shpalljes së njoftimit për punësim, kishin njoftuar me sms DROSHKSH Elbasan, por nuk dërguan prova për të dokumentuar këtë fakt, dhe masat që janë marrë për të rregulluar situatën, por kanë vazhduar procedurat me shpalljen e fituesit dhe kërkimin e lejimit për emërimin e kandidatit të shpallur fitues.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët rezulton se:

- Kandidatja D.C është e pajisur me: - Diplomë të Nivelit të Parë në Shëndet Publik. – Diplomë Master Profesional në Shëndet Publik. – Diplomë Master i Shkencave në Administrim Publik me profil Administrim Publik.
- Ankuesi A.V është i pajisur me Diplomë të Universitetit të Tiranës, në degën: Mjekësi e Përgjithshme.
- Kandidatja D.M është e pajisur me: - Diplomë të Nivelit të Parë në Shëndet Publik. – Diplomë Master i Shkencave në Shëndet Publik.

Referuar njoftimit të datës 30.06.2021 për pozicionin shef shërbimi në NJVKSH Berat nga autoriteti përgjegjës (OSHKSH), kriteri ka qenë: Arsim i Lartë, Universiteti i Mjekësisë (Mjekësi/Shëndet Publik). Niveli minimal i arsimit: Master Shkencor.

⁶ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 1.26.00.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatja e shpallur fituese rezulton se ajo nuk zotëron diplomë master i shkencave në shëndet publik apo diplomë në mjekësi të përgjithshme, në mënyrë që të plotësonte kriterin e kërkuar, master shkencor në Mjekësi/Shëndet Publik.

Referuar njoftimeve⁷ për punësim të shpallura nga DQOSHKSH dhe njoftimit të dërguar nga NJVKSH Berat, për pozicionin shërbimi në Sektorin e Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH të qyteteve të ndryshme të Shqipërisë, lidhur me kriterin e arsimit të kërkuar, rezulton se:

- Njoftimi datë 24.02.2020 për pozicionin në NJVKSH Shkodër: Arsim i Lartë, Universiteti i Mjekësisë. Niveli Master Shkencor.
- Njoftimi datë 22.07.2020 për pozicionin në NJVKSH Kolonjë: Arsim i Lartë, preferohet Shëndet Publik, Universiteti i Mjekësisë. Niveli Master Shkencor.
- Njoftimi datë 31.05.2021 për pozicionin në NJVKSH Tepelenë: Arsim i Lartë, Mjekësi e Përgjithshme.
- Njoftimi datë 22.12.2021 për pozicionin në NJVKSH Përmet: Arsim i Lartë, Mjekësi e Përgjithshme.

Në analizë të këtyre shpalljeve nga DQOSHKSH për pozicione të njëjta apo të ngjashme me pozicionin objekt shqyrtimi, rezulton se autoriteti përgjegjës në kriterin e arsimit ka kërkuar diplomë të nivelit master shkencor në fushën e studimit mjekësi e përgjithshme apo shëndet publik.

Përsa më sipër dhe referuar Kreut III, pika 8/ç të VKM-së nr. 419, datë 04.07.2018 “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor*”, në të cilin përcaktohet se janë drejtoritë rajonale që kanë për detyrë të kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor për rajonin përkatës, komisioni i vlerësimit nuk kishte autoritetin ligjor për të mos marrë për bazë kriterin e arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore. Duke pasur parasysh se njoftimi për punësim është shpallur nga DQOSHKSH në datë 30.06.2021 dhe komisioni i vlerësimit është krijuar në datë 21.07.2021⁸, Komisioneri vlerëson se NJVKSH Berat dhe komisioni i vlerësimit kanë pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të njoftuar organin epror për kriterin e arsimit dhe të prisnin udhëzimin për rregullimin e situatës së krijuar.

Në kontekst të analizimit të fakteve sipër përmendur, Komisioneri vlerëson se ndryshimi i kriterit të arsimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit e ka vendosur ankuesin në kushte të pafavorshme, gjatë procedurës së konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të Sektorit të Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

⁷<http://oshksh.gov.al/njoftim-per-punesim-67/>
<http://oshksh.gov.al/njoftim-per-punesim-260/>

⁸ Referuar Urdhërit nr. 505, datë 21.07.2021 për krijimin e komisionit të vlerësimit.

C. Shkaku i mbrojtur

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Ankuesi shpjegon se, është diskriminuar për shkak të bindjeve politike pasi është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), dhe bindjet e tij politike janë të kundërta me ato të drejtores së NJVKSH Berat. Në mbështetje të këtij pretendimi ankuesi ka depozituar Vërtetimin nr. 54, datë 15.06.2021, të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Berat, në të cilin vërtetohet se A.V është anëtar i Partisë Demokratike që nga data 25.05.1997 dhe ka përfaqësuar Partinë Demokratike si kandidat për deputet në vitin 2001 dhe Këshilltar Bashkiak në Bashkinë Berat, në vitet 2007-2011.

Referuar deklaratës⁹ së bërë gjatë seancës dëgjimore, Xh.K , Drejtore e NJVKSH Berat dhe kryetare e komisionit të vlerësimit, ka qenë e komanduar si Kryetare e Forumit të Rinisë Eurosocialiste të Shqipërisë (FRESSH), Dega Berat.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të *“bindjeve politike”* të kundërta me Drejtoreshen e NJVKSH Berat.

D. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë procedurës së konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të Sektorit të Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

⁹ Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 55.05.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: (a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; (b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; (c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; (d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*¹⁰, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë¹¹. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në bindjet politike të personit.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹² “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që

¹⁰ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹¹ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

¹² Ratifikuar me Ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

*Karta Sociale Europiane*¹³ në nenin 1, pika 2, parashikon: “*Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹⁴. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹⁵

Në bazë të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, neni 12, pika 1, germa a) dhe b), parashikon se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve*”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen

¹³ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹⁴ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

¹⁵ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, paragrafi 15.

diskriminuere nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁶ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar¹⁷ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër, në këtë rast NJVKSH Berat, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet dhe në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se : *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuere dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 20, *“Për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”*, pika 10, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kuturore në vitin 2009, parashikohet se: *“...Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin gjithashtu veprime ose mosveprime të dëmshme mbi bazën e një shkakut të mbrojtur, kur nuk ka një situatë të ngjashme të krahasueshme”*.

Në situata të caktuara, kur trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm vjen si pasojë e mosrespektimit dhe moszbatimit të standarteve dhe kërkesave të miratuara nga legjislacioni në fuqi, krahasuesi për qëllime të të provuarit të sjelljes diskriminuere mund të konsiderohet standarti apo kërkesa që nuk është respektuar dhe që ka sjellë si pasojë trajtimin e padrejtë. Pra, për të vërtetuar sjelljen diskriminuere, nuk është e nevojshme në çdo rast identifikimi i një krahasuesi konkret, por kërkesat për të provuar se diskriminimi ka ndodhur konsiderohen të përmbushura edhe nga një krahasues hipotetik, që në rastin konkret është mënyra se si NJVKSH Berat dhe Komisioni i Vlerësimit i kryesuar nga Drejtoresha e NJVKSH Berat, duhet të kishte respektuar standartet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni i sipërcituar, për vlerësimin e kriterit të arsimit të lartë për pozicionin objekt shqyrtimi.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie*

¹⁶ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁷ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuere dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁸

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë është shkakun e mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹⁹”.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, duke provuar në këtë mënyrë bindjet dhe aktivitetin e tij politik. Ankuesi ka parashtruar se fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato të titullarit të institucionit, ka sjellë si pasojë trajtimin e tij të padrejtë dhe të pafavorshëm duke mosrespektuar kriterin e arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

¹⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁹ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Bindjet politike përbëjnë një të dhënë sensitive të personit dhe shpesh herë punëdhënësi mbrohet me faktin se ai e ka të ndaluar që të mbledhë të dhëna për bindjet politike të punëmarrësve, e për rrjedhojë ai nuk ka si të ketë dijeni për bindjet politike të punëmarrësve të vet. Në lidhje me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, provat rrethore mund të hedhin poshtë pretendimin e punëdhënësit se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit dhe për këtë arsye të provohet se punëdhënësi ka patur dijeni.

Bazuar në dokumentacionin që disponohet nga procedura hetimore, Komisioneri vlerëson se ankuesi e mbart shkakun e bindjes politike.

Komisioneri duke vlerësuar marrëdhëniet e punës mes drejtueses të institucionit dhe ankuesit, ngre dyshimin e arsyeshëm se veprimi NJVKSH Berat, duke mosrespektuar kriterin e arsimit gjatë procedurës së vlerësimit të kandidatëve, ka qenë veprim i pajustificuar dhe i njëanshëm, në dëm të ankuesit dhe i lidhur me bindjen e tij politike.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Drejtorja e NJVKSH Berat kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt.

Në këto kushte Drejtorja e NJVKSH Berat kishte barrën e provës që të provonte ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjes politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkaqet e pretenduara, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për këtë motiv.

Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Drejtores së NJVKSH Berat, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë të ankuesit mbeten shkakun i bindjes politike. Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore.

Nga Drejtorja e NJVKSH Berat në cilësinë dhe të kryetares së komisionit të vlerësimit, nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se kishte arsye ligjore për mosrespektimin e kriterit të arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Drejtorja e NJVKSH Berat, nuk arriti të faktonte përpara Komisionerit se:

- Propozimi i kriterit të arsimit, për pozicionin shef shërbimi, ishte i përfshirë në detyrat e NJVKSH Berat.

- Kishte autoritet për të ndryshuar kriterin e arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Kishte arsye objektive dhe të justifikuar për të vlerësuar kriterin e arsimit.
- Kishte njoftuar autoritetin përgjegjës për gabimin e konstatuar.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se A.V është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Duke iu referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike, dhe faktit që komisioni i vlerësimit nuk arriti të provojë se mosrespektimi i kriterit e arsimit ka ndodhur për një shkak të ligjshëm, Komisioneri gjykon se, mosrespektimi i kriterit e arsimit të shpallur nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore nga ana e komisionit të vlerësimit, nuk motivohet nga shkaqe ligjore.

Në përfundim përsa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon bindjen dhe vlerëson se shtetasi A.V është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e NJVKSH Berat, trajtim i cili ka ardhur për shkak të bindjes politike të ankuesit.

Për rrjedhojë NJVKSH Berat ka shkelur nenin 3, pika 1 dhe 2, nenin 5, pika 1, dhe nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e mosrespektimit të vlerësimit të kriterit të arsimit, duhet të jetë ndreqja e pasojave, lidhur me procesin konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të Sektorit të Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenin 1, nenin 3, pika 1 dhe 2, nenin 5, pika 1, nenin 7, nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b), nenin 32.1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 7.1, 10, 11 dhe 12, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike të shtetasit A.V, nga ana e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat.
2. Mospranimin e pretendimit për diskriminim për shkak të bindjes politike, lidhur me procedurën e largimit të A.V nga pozicioni i Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare, nga ana e DROSHKSH Elbasan.
3. Në referim të pikës 1, Drejtoria Rajonale e OSHKSH Elbasan dhe NJVKSH Berat, sipas kompetencave ligjore, të marrin masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me procesin konkurimit për pozicionin e shefit të shërbimit të Sektorit të Shërbimit të Kujdesit të Shëndetit Parësor në NJVKSH Berat.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Drejtoria Rajonale e OSHKSH Elbasan dhe NJVKSH Berat, sipas kompetencave ligjore, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA